



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, më 11 Maj 2010
Ref. nr.:RK15 /10

VENDIM

Rasti Nr. KI 21/09

Agim Kryeziu
kundër
Komunës së Prizrenit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gjykata Kushtetuese në përbërje:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendës Kryetar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Robert Carolan, Gjyqtar
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Iliriana Islami, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, Gjyqtare
Almiro Rodrigues, Gjyqtar dhe
Altay Suroy, Gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës, Agim Kryeziu, është me vendbanim në Prizren.

Pala kundërshtare

2. Pala Kundërshtare është Komuna e Prizrenit.

Kopje e vërtetuar
Overena kopija
Certified Copy

Subjekti i lëndës

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon që ka parashtruar një sërë kërkesash pranë komunave të Prizrenit dhe Malishevës, në të cilat ka kërkuar ndihmë që do t'i mundësonte rindërtimin e pronës e cila i ishte dëmtuar gjatë luftës, por deri tani nuk kishte marrë ndonjë përkrahje.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në vijim: Kushtetuta); neni 20 i Ligjit 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në vijim: Ligji); dhe neni 54(b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në vijim: Rregullorja e Punës).

Përmbledhje e procedurës para Gjykatës

5. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën e tij pranë Gjykatës Kushtetuese më 15 qershor 2009. Më 18 shkurt 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit Raportues, Almiro Rodrigues, Kolegji Shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (Kryesues), Snezhana Botusharova dhe Iliriana Islami, brenda të njëjtës ditë i paraqiti rekomandimet e veta për të refuzuar lëndën si të papranueshme para përbërjes së plotë të Gjykatës.

Faktet

6. Nga dokumentet e parashtruara nga Parashtruesi i kërkesës bëhet e ditur se më 15 maj 2001, gjatë kohës kur jetonte me 7 anëtarë të familjes në një shtëpi që kishte pësuar dëmtime substanciale gjatë luftës, ai kishte marrë një konfirmim nga Komisioni për Ndërtim dhe Rindërtim i Komunës së Malishevës që vërtetonte se atij nuk i ishin siguruar kurrfarë materiale ndërtimore. Një konfirmim tjetër i ishte dërguar Parashtruesit të kërkesës më 5 gusht 2002, në të cilin thuhej se Parashtruesi i kërkesës nuk kishte marrë ndihmë për rindërtimin e shtëpisë dhe se ky konfirmim do duhej shfrytëzuar për tu regjistruar në programin e rindërtimit. Më 15 gusht 2002, Parashtruesi i kërkesës bleu një parcelë toke në Komunën e Prizrenit.

7. Me një letër, të datuar 3 gusht 2004, Parashtruesi i kërkesës, i cili duket se paraprakisht i kishte paraqitur komunës së Prizrenit një kërkesë për ndihmë, u informua nga Drejtoria për Ndërtim, Rindërtim, Zhvillim dhe Investime Publike e Prizrenit se ndihma do të mund t'i sigurohej vetëm qytetarëve të Komunës së Prizrenit dhe se ai do duhej t'ia paraqesë problemin e tij organeve kompetente të Komunës së Malishevës, ngase shtëpia e djegur e tij gjendej në fshatin Pagarushë të Komunës së Malishevës.

8. Më 12 shtator 2006, Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Komuna e Prizrenit që të rishqyrtojë kërkesën e tij për material ndërtimor për shtëpinë e tij në Komunën e Malishevës. Ai i referohej faktit që ai i kishte blerë një parcelë toke në Prizren dhe se ishte tani, së bashku me familjen e tij, banor i Prizrenit.

9. Përmes letrës së datës 4 prill 2007, Parashtruesi i kërkesës rikonfirmoi kërkesën e tij pranë Komunës së Prizrenit, duke e informuar atë se deri në atë datë ai nuk kishte

pranuar kurrfarë ndihme në materiale ndërtimore nga asnjë komunë, megjithëse nuk kishte kulm mbi kokë, se përballej me një gjendje serioze shëndetësore, kishte familje shtatanëtarëshe dhe se ishte i papunë. Ai parashtroi një kërkesë tjetër më 25 maj 2007.

10. Prapë, përmes letrës së datës 26 maj 2009, Parashtruesi i kërkesës i shkroi Drejtorisë për Rindërtim të Komunës së Prizrenit, duke sqaruar se përkundër kërkesave të tij të shumta, ende nuk ka pranuar kurrfarë ndihme, megjithëse Ombudspersoni, të cilit gjithashtu i ishte drejtuar ai, i kishte thënë se herët a vonë ai do të përfitonte ndihmë nga Komuna e Prizrenit. Ai shtoi se ai do të kërkonte realizimin e interesave të tij deri në Gjykatën Kushtetuese.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

11. Parashtruesi i kërkesës ankon se që nga fundi i luftës ai i ka adresuar komunave të Prizrenit dhe Malishevës një sërë kërkesash për rindërtim të shtëpisë së tij që i ishte dëmtuar gjatë luftës, por deri tani nuk kishte përfituar kurrfarë ndihme. Ai pretendon se e drejta e tij për rindërtim të pronës i është shkelur.

Komentet e palës kundërshtare

12. Pala kundërshtare, e cila është informuar mbi Kërkesën nga Zyra e Regjistrimit e Gjykatës më 18 dhjetor 2009, nuk ka parashtruar komentet e veta brenda periudhës prej 45 ditësh, siç parashihet me nenin 22.2 të Ligjit.

Vlerësim për pranueshmerinë e kërkesës

13. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi Kërkesën e Parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmerisë të cilat përcaktohen në Kushtetutë.

14. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”;

dhe nenit 47.2 të Ligjit, që rregullon se:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

15. Megjithatë, Gjykata vëren se në Kërkesën e tij, Parashtruesi nuk ka paraqitur kurrfarë dëshmish se ka paraqitur ankesë ndaj vendimeve të Komunës së Prizrenit, apo atyre të Komunës së Malishevës, apo që ka shfrytëzuar mjetet tjera juridike, që i ka pasur në dispozicion në bazë të ligjit të zbatueshëm, në mënyrë që të sfidojë vendimet e kontestuara apo të ankohet për shkak të mungesës së një vendimi.

16. Siç thuhet në Lëndën Nr. KI 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës (Vendimi Nr. RK-04/10 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 27 janar 2010) Gjykata dëshiron të theksojë se arsyeya për rregullin e shterjes së mjeteve, sipas interpretimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih nenin 53 të Kushtetutës), është për t'i dhënë autoriteteve në fjalë, përfshirë edhe gjykatat, mundësi që të parandalojnë apo përmirësojnë shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike në rastin e shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky paraqet një aspekt të rëndësishëm të karakterit suplementar të Kushtetutës (shih, mutatis mutandis, ECHR, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, vendim i datës 28 qershor 1999). Megjithatë, nuk është e domosdoshme që të drejtat kushtetuese të ngriten në mënyrë eksplicite në procedurat e përmendura. Edhe nëse çështja është ngritur në mënyrë implicite apo në substancë, kushti i shterjes së mjeteve do të jetë përmbushur (shih, mutatis mutandis, ECHR, Azinas kundër Qipros, nr. 56679/00, vendim i datës 28 prill 2004).

17. Në lidhje me këtë, Gjykata dëshiron të theksojë se nga Parashtuesit e kërkesës kërkohet t'i shterin vetëm mjetet juridike që i kanë në dispozicion dhe që janë efektive. Mjetet juridike diskrecionale apo të jashtëzakonshme nuk ka nevojë të shteren, për shembull, nuk ka nevojë të kërkohet nga një gjykatë të bëjë revizion të vendimit të vet (shih, mutatis mutandis, ECHR, Cinar kundër Turqisë, nr. 28602/95, vendim i datës 13 nëntor 2003). Në rastet kur Parashtuesi i kërkesës ka shfrytëzuar një mjet juridik të cilin Gjykata e konsideron si të papërshtatshëm, koha e shfrytëzuar për këtë nuk do të pengojë skadimin e limitit katërmujor (neni 49 i Ligjit, "Afatet Kohore"), që mund të shpjerë në refuzimin e ankesës si të pakohshme (shih, mutatis mutandis, ECHR, Prystavka, Rezgui kundër Francës, nr. 49859/99, vendim i datës 7 nëntor 2000).

18. Në lëndën në fjalë, Parashtuesi i kërkesës ka paraqitur ankesën kushtetuese të tij drejtpërdrejt në Gjykatë, duke pretenduar se i është shkelur e drejta e tij për rindërtim të pronës, pa u thirrur në asnjë nen të Kushtetutës apo të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.

19. Për më tepër, Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, i datës 22 korrik 2005, në Kaptinën IX, përcakton se "Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër një akti administrativ ose kundër refuzimit të paligjshëm për nxjerrjen e aktit administrativ." (neni 127.2), ndërsa "Organi administrativ të cilit i drejtohet ankimi shqyrton ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktit të kontestuar." (neni 127.3). Më tej, Ligji përcakton se "Palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë shteruar mjetet administrative të ankimit." (neni 127.4).

20. Sidoqoftë, në parashtrësit e tij, Parashtuesi i kërkesës nuk ka dëshmuar në çfarëdo mënyre se përse ai konsideron se mjetet juridike, të përmendura në Ligjin Nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative, përfshirë edhe ankesën pranë gjykatave të rregullta, nuk kanë qenë në dispozicion, apo nëse kanë qenë në dispozicion përse ato nuk do të ishin efektive dhe rrjedhimisht nuk ka nevojë të shteren.

21. Në rrethana të tilla, Parashtuesi i kërkesës nuk mund të konsiderohet se i ka plotësuar kushtet sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe nenin 54(b) të Rregullores së Punës, njëzëri,

VENDOS

- I. TA REFUZOJË Kërkesën si të papranueshme.
- II. Palët do të njoftohen për vendimin dhe vendimi do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Almiro Rodrigues

Prof. Dr. Enver Hasani